



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 2266 Prot

Tiranë, më 4.04.2018

URDHËR

Nr. 206 datë, 4 / 04 2018

PËR

**FLUKSIN E INFORMACIONIT DHE KOORDINIMIN NËPËRMJET PLATFORMËS
SË BASHKËQEVERISJES**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Të gjitha ankesat e ardhura pranë Ministrisë së Kulturës në format shkresor apo elektronik, do të administrohen nga Zyra për Bashkëqeverisjen e atashuar pranë Ministrisë së Kulturës (“Zyra për Bashkëqeverisjen”), nëpërmjet platformës digjitale të bashkëqeverisjes (Platforma e Bashkëqeverisjes”).
2. Me marrjen e ankesës, koordinatori i Zyrës për Bashkëqeverisjen ia përcjell atë, brenda 1 ditë pune nga data e marrjes, Drejtorit të Përgjithshëm të strukturës përkatëse me të cilën lidhet ankesa, nëpërmjet postës elektronike.
3. Drejtori i Përgjithshëm i strukturës përkatëse dërgon përgjigjen pranë Zyrës për Bashkëqeverisjen, brenda 5 ditë pune nga marrja e ankesës, duke vënë në dijeni Kabinetin e Ministrit, Zëvendësministrin dhe Sekretarin e Përgjithshëm.
4. Afati i përcaktuar në pikën 3 të këtij urdhri, mund të shtyhet me 1 ditë pune, kur përgjigja e ankesës ka nevojë për sqarime të natyrës teknike.
5. Ankesat e marra në formë shkresore i përcillen të skanuara Zyrës për Bashkëqeverisjen, brenda 2 ditë pune nga data e marrjes, për t’u trajtuar nëpërmjet procesit të përshkruar më sipër.

6. Me marrjen e përgjigjes, Zyra për Bashkëqeverisjen ia përcjell atë qytetarit ose subjektit, brenda 1 ditë pune nëpërmjet Platformës për Bashkëqeverisjen dhe, në rastin e ankesave të marra në formë shkresore, një kopje e përgjigjes dërgohet në zyrën e protokollit të Ministrisë. Në rastin e ankesave në formë shkresore, përgjigja dërgohet me firmë të Sekretarit të Përgjithshëm.
7. Ngarkohen strukturat e Minsitrisë së Kulturës që të respektojnë afatet dhe procedurat e përcaktuara për shqyrtimin e ankesave. Në rast të mosrespektimit të afateve dhe procedurave, procedohet sipas legjislacionit në fuqi.
8. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorët e Përgjithshëm të Ministrisë dhe titullarët e institucioneve të varësisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI